



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3 Prot.

Vlorë, më 16 / 03 / 2021

V E N D I M

Nr. 01, datë 16.03.2021

"PËR NDARJEN E TË ARDHURAVE NGA TARIFAT E SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA QENDRA LLL"

Bazuar në nenin 47, neni 48, pika "dh", të Ligjit nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*"; në nenin 9, pika 1, germa "dh" dhe "g", të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit; neni 6, pika 4, Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 "*Për Funksionimin e Sistemit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të Punonjësve Arsimorë*"; si dhe propozimit të Administratorit me shkresën Nr. 2, datë 12.03.2021.

Bordi i Administrimit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë";

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën prej 1200 lekë për kredit për kurset e trajnimit të zhvilluara nga Qendra LLL;
2. Të miratojë pagesën e trajnuesve për modul në masën 60% për trajnues dhe 40% për institucionin mbi vlerën totale të çdo kursi të zhvilluar nga trajnuesit;
3. Masa 40% për institucionin të përdoret për qëndrueshmërinë e qendrës, për shpenzime operative dhe ri-investimin në qendër.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Gëzim LIÇAJ

